



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Datë/a:	02.02.2021
Referenc-ë:	07-353/04-18850/21
Për/ Za/ To:	Lëvizja VETËVENDOSJE
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi-Zyrtarja: Liridona Kastrioti Kontrolloi-Udhëheqës i Sektorit: <i>PSR</i> Habib Qorri
Tema/ Subjekat/Subject:	Njoftim

Drejtorija e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit ka pranuar kërkesën me nr protokoll 07-353/04-18850/21 nga Lëvizja VETËVENDOSJE për shfrytëzimin e hapësirës publike mbrapa Pallatit të Rinisë dhe Sporteve me datën 03.02.2021.

Drejtorija e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit pas shqyrtimit të kërkesës për mbajtjen e tubimit elektoral në hapësirën mbrapa Pallatit të Rinisë dhe Sporteve hapësirë kjo nën menaxhimin e Ndërmarrjes Publike "Prishtina Parking" ju njoftojmë se, për marrjen e lejes për shfrytëzimin e kësaj hapësire duhet ti drejtoheni Ndërmarrjes Publike "Prishtina Parking" e cila edhe duhet të bëjë lirim të hapësirës nga veturat.

Sa i përket DSHPMSH hapësira mund të shfrytëzohet pas marrjes së pëlqimit nga Ndërmarrja përkatëse duke pasur parasysh se:

- Gjatë organizmit dhe mbajtjes së këtij tubimi organizatori obligohet që të siguroj respektimin e plotë të gjitha masat e parapara nga IKSHPK për organizime të tilla në kohë pandemie. Organizatori obligohet që të siguroj dhe të monitoroj gjatë gjithë kohës së këtij organizimi që numri i pjesëmarrësve të jetë i kufizuar, të ketë distancë të mjaftueshme, secili pjesëmarrës ti bart masat mbrojtëse si dhe masa tjera të përcaktuar nga IKSHPK për mbrojtje nga COVID.

- Organizatorët obligohen gjithashtu të marrin pëlqim për mbajtjen e tubimit nga Policia e Kosovës.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pavlefshëm.

